

Data: 10.09.2025

**PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS - MALL
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE
PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “F.V 3 transformatorë 10/0.4KV për nevojat e HEC Vau Dejës, 2 transformatorë 6/0.4KV për nevojat e HEC Koman dhe F.V monitorues të një gazi për transformatorët me vaj të nevojave të përgjithshme”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): PAJISJE TË NDRYSHME - 39300000-5.

VLERA E FONDIT LIMIT: 72,000,000 (Shtatëdhjetë e dy milion) Lekë pa TVSH ose 741,350 (Shtatëqind e dyzet e një mijë e treqind e pesëdhjetë) Euro pa TVSH.

Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 10/09/2025 është 97.12 Lekë/Euro.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Korporata Elektroenergjitike Shqiptare sh.a, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: “Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të

vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, si dhe nenin 43, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. VKM-së nr.922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklarave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë të mallrave të furnizuara.

Argumentim: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim nga Prodhuesi ose Distributor i Autorizuar për pajisjet që do të ofrojë.

Dokumentacioni duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të vërtetohet lidhja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentim: Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesit ose shpërndarësit siguron që operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi ose shpërndarësi i autorizuar për ofrimin e mallrave të kërkuara për Autoritetin Kontraktues. Gjithashtu, kjo siguron treguesit e cilësisë së mallrave që do të blihen dhe konfirmon prodhimin e tyre në përputhje me standardet. Kjo kërkesë ndihmon Autoritetin Kontraktues të vlerësojë mundësinë që Operatori Ekonomik të realizojë me sukses kontratën.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë raportet e testimit (type tests) për të gjitha mallrat objekt prokurimi, të cilat verifikojnë se pajisjet janë në përputhje me kërkesat e AK.

Argumentim: Ky kriter është përcaktuar bazuar në Nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik," dhe në Nenin 40, pika 6, shkronja (c) të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik." Ky kriter i siguron Autoritetit Kontraktues që operatori ekonomik do të furnizojë mallra të besueshme, të cilat plotësojnë standardet e kërkuara dhe janë plotësisht në përputhje me specifikimet teknike të përcaktuara.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij minimalisht 1 (një) Inxhinier elektrik të çertifikuar nga prodhuesi / institucione të autorizuar për monitorimin e një gazi të vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe në instalimin dhe komisionimin e sistemit në terren.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Argumentim: Kërkesa që Operatorët Ekonomikë të kenë në stafin e tyre minimalisht një (1) inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi ose nga institucione të autorizuar ka për qëllim të sigurojë që monitorimi i gazit dhe vajit të transformatorëve të fuqisë, si dhe instalimi dhe komisionimi i sistemit në terren, të kryhen në përputhje me standardet teknike dhe procedurat e sigurisë. Sa me siper AK kerkon nje inxhinier te certifikuar ne nivelin e duhur profesional per venien ne funksion te sistemeve qe do te furnizohen. Ky kriter eshte ne perputhje me natyren dhe permasat e kontrates dhe lidhet drejt per drejt me aftesine profesionale , reputacionin dhe besueshmerine e OE per aftesite teknike. Ky kriter i mundëson Autoritetit Kontraktor të vlerësojë kapacitetin teknik dhe profesional të Operatorit Ekonomik, duke siguruar që kontrata do të përmbushet me sukses dhe në mënyrë të sigurt. Ai është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke garantuar besueshmërinë dhe profesionalizmin e OE-së në ekzekutimin e objektit të prokurimit.

2.3.5 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar, në stafin e tij, minimalisht dy (2) teknikë elektrikë dhe një (1) teknik ndërtimi, për kryerjen e punimeve civile dhe elektrike të jenë të certifikuar çertifikatë të sigurimit teknik, lëshuar nga shoqëri të akredituara.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diploma;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për të paktën Qershor 2025 – Gusht 2025.

Argumentim: Kërkesa që Operatorët Ekonomikë ofertues të kenë të punësuar minimalisht dy (2) teknikë elektrikë dhe një (1) teknik ndërtimi ka për qëllim sigurimin e ekzekutimit të punimeve civile dhe elektrike në përputhje me standardet profesionale dhe ligjore. Certifikimi i teknikëve me çertifikatë sigurimi teknik, të lëshuar nga shoqëri të akredituara, garanton aftësitë profesionale, përvojën dhe njohuritë e nevojshme

për të kryer punimet në mënyrë të sigurt dhe me cilësi të lartë. Ky kriter siguron që OE ka kapacitetin teknik dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës, duke minimizuar rreziqet gjatë kryerjes së punimeve dhe duke garantuar përputhshmërinë me standardet teknike. Ai është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke siguruar besueshmërinë dhe profesionalizmin e OE-së në realizimin e objektit të kontratës.

2.3.6 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi në mënyrë që të provohet pajtueshmëria me specifikimet teknike. *Në katalog, të markohen në mënyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

Argumentim: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 40, pika 6, gërma b), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendorsja e këtij kriteri, në përputhje me legjislacionin në fuqi, i shërben Autoritetit Kontraktor për të vlerësuar nëse një Operator Ekonomik ka kapacitetet e nevojshme për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt të prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ✚ **ISO 9001:** – “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- ✚ **ISO 14001:** – “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- ✚ **ISO 45001:** – “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;
- ✚ **ISO 50001:** – “Sistemi i menaxhimit të energjisë”.

- **SSH ISO 9001:2015 – Sistemi i menaxhimit të cilësisë**
Ky standard është i nevojshëm për certifikimin e realizimit të cilësisë, identifikimin e rreziqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar që mallrat e ofruara janë të cilësisë së duhur, si dhe për të monitoruar dhe kontrolluar proceset.
- **SSH ISO 14001:2015 – Sistemi i menaxhimit të mjedisit**
Ky standard është i nevojshëm që kontraktori të ketë një staf të vetëdijshëm mbi politikat mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tij në mjedis. Aktivitetet e kontraktorit duhet të jenë të organizuara në mënyrë që të kontrollohet ndikimi mbi mjedisin dhe të ofrohet përgjigje adekuate në rast emergjencash mjedisore.

- **SSH ISO 45001:2018 – Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit në punë**
Ky standard është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e të gjithë personelit të shoqërisë lidhur me masat e mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë në punë, si dhe për përfshirjen e punonjësve në vlerësimin e rreziqeve dhe masave parandaluese.
- **SSH ISO 50001:2011 – Sistemi i menaxhimit të energjisë**
Ky standard është i nevojshëm për stimulimin e kontraktorëve për identifikimin e mundësive për reduktimin e konsumit të energjisë, duke përfshirë stafin në këtë proces dhe optimizimin e përdorimit të burimeve energjetike.

Argumentimi:

Kërkesa lidhur me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, dhe nenin 79 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar. Certifikatat sigurojnë që operatori ekonomik të ketë sistemet e nevojshme të menaxhimit për cilësinë, mjedisin, energjinë dhe sigurinë në punë, duke garantuar përmbushjen e kërkesave të kontratës me efikasitet dhe siguri.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat ose deklaratat e markimit CE/SSH, të cilat vërtetojnë se prodhuesi është në përputhje me kërkesat e sigurisë sipas standardeve europiane dhe shqiptare:

- ✚ **EN IEC 61000-6-1: / SSH EN 61000-6-1 –**
- ✚ **EN 61000-6-3: + A1: / SSH EN 61000-6-3: + A1:**

Argumentim: Ky kriter është i përshtatshëm dhe proporcional me objektin e kontratës dhe zbatohet në përputhje me nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Ai siguron që produktet e ofruara në procedurën e prokurimit të jenë të prodhuara në përputhje me kërkesat dhe standardet përkatëse.

Vendosja e këtij kriteri është e domosdoshme për garantimin e cilësisë dhe sigurisë së mallrave të prokuruar. Markimi CE shërben si dëshmi e qartë se pajisjet janë të përshtatshme për përdorim në tregun evropian dhe se ato janë prodhuar dhe testuar sipas standardeve të njohura për cilësi dhe siguri.

Në veçanti, kërkesa për përputhshmëri me standardet SSH EN 61000-6-1 dhe SSH EN 61000-6-3 garanton mbrojtje nga ndërhyrjet elektromagnetike, një element kyç për impiantet me tension të lartë, si HEC-et. Ky kriter ofron autoritetit kontraktor sigurinë se mallrat e ofruara nuk do të jenë me cilësi të ulët, nuk do të jenë të rrezikshme dhe nuk do të ndikojnë negativisht në funksionimin e pajisjeve të tjera të centralit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje të plotë me standardet shqiptare dhe homologët ndërkombëtarë IEC/EN. Kërkesat për parametrat elektrikë janë bazuar në llogaritjet e sistemit të shpërndarjes 10 kV në HEC Vau i Dejës dhe 6 kV në HEC Koman. Përmasat e transformatorëve, çelave dhe kabinave janë përcaktuar duke marrë parasysh vendin ekzistues të instalimit, me qëllim përshtatjen dhe lidhjen e linjave të fuqisë brenda hapësirave të disponueshme. Duke pasur parasysh klasifikimin sipas rëndësisë së transformatorëve, është kërkuar monitorim i tyre vetëm për një gaz, në përputhje me standardet për monitorimin dhe mirëmbajtjen e transformatorëve.

Njësia e Prokurimit